



Forumi për Iniciativa Qytetare

ZBATIMI I POLITIKAVE KUNDËR NARKOTIKËVE ILEGAL

Maj 2011

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ)

në bashkëpunim me:

Instituti Kosovar për Drejtësi (KLI),
Community Building Mitrovica (CBM) - Mitrovicë,
Iniciativa për Progres (INPO) - Ferizaj,
Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC) - Gjilan,
Akademia për Trajnjime dhe Asistencë Teknikë (ATTA) - Prizren,
Syri i Vizionit (SiV) – Pejë

Përbajtja:

Lista e shkurtesave	2
Hyrje	3
Metodologja.....	3
Politikat e Kosovës në luftimin e drogave.....	4
Mekanizmat institucional dhe prioritetet në bazë të PVPE.....	5
PVPE.....	6
Rezultatet.....	7
Analizë.....	9
Rekomandim.....	10

Listë e shkurtesave

1. BE – Bashkimi Evropian
2. DK – Dogana e Kosovës
3. DHKEK - Drejtoria për Hetime të Krimit Ekonomik dhe Korrpcionit
4. DHN – Drejtoria për Hetim të Narkotikëve
5. EULEX - Misioni i Unionit Evropian për Sundimin e Ligjit
6. FIQ – Forumi për Iniciativa Qytetare
7. GB - Grupi Bashkërendues
8. IGJK - Instituti Gjyqësor i Kosovës
9. IKSHP – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
10. IPA- Instruments for Pre-Accession Assistance
11. KE - Komisionit Evropian
12. MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
13. MD – Ministria e Drejtësisë
14. MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
15. MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
16. MSH – Ministria e Shëndetësisë
17. OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
18. PK – Policia e Kosovës
19. PV – Plani i Veprimit
20. PVPE - Plani për Veprim i Partneritetit Evropian
21. QKUK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës
22. QRS – Qendra për Rehabilitim Social
23. QPS – Qendra për Punë Sociale
24. SECI – Nisma e Evropës Jug-lindore për Bashkëpunim
25. SHPK - Shërbimi Policor i Kosovës
26. SHKK - Shërbimi Korrektues i Kosovës
27. U.D – Ushtrues Detyre
28. UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovës

Hyrje

Hetimi dhe luftimi i krimit të organizuar është një nga kushtet e ndërtimit të një shoqërie prosperuese. Duke qenë dukuri transnacionale, luftimi i drogave është edhe parakusht për integrim të Kosovës në Bashkimin Evropian. Për këtë, ky hulumtim ka për qëllim të vlerësoj veprimet e qeverisë së Kosovës në luftimin e drogave dhe në veçanti rritjen e kapaciteteve të Policisë së Kosovës kundër drogave.

Prania e drogave dhe narkotikëve është e dëmshme për një shoqëri¹ sepse cenon individët të gëzojnë të drejtat e tyre në shfrytëzimin e të mirave që i kanë. Shpërdorimi i narkotikëve jo vetëm që dëmton të ardhmen e individëve, por ndikon edhe në sigurinë e shtetit si dhe shoqërisë, pasi që përdoruesit e drogave dhe grupet kriminale cenojnë pronën dhe lirinë e të tjerëve.

Për këtë, Republika e Kosovës ka hartuar politika për t'u ballafaquar me shpërdorimin e narkotikëve. Pas vitit 2008, kur siguria u bë përgjegjësi e institucioneve vendore, është hartuar Strategjia Kombëtare Kundër Drogave 2009-2012, me qëllim të zhvillimit të politikave, kapaciteteve institucionale për të ulur këtë dukuri. Megjithatë, deri më tanë nuk ka pasur ndonjë vlerësim se sa është zbatuar kjo strategji dhe se çfarë efekti ka pasur.

Metodologja

Ky raport vlerësues bazohet në strategjinë e hulumtimit kualitativ, përkatësisht përmes strategjisë hulumtuese të vlerësimit (evaluation research strategy). Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është vlerësimi i zbatimit të politikave të caktuara. Pyetja kryesore që del nga kjo strategji është 'a ka arritur të përbushë qëllimin e caktuar një politikë ose intervenim'²? Për të adresuar vlerësimet do të shfrytëzohen Raporti i Progresit i Komisionit Evropian (KE) dhe Plani për Veprim i Partneritetit Evropian (PVPE). Raporti i KE shfrytëzohet sepse identifikon të metat në fushën e sundimit të ligjit, përderisa PVPE është një dokument që ka për qëllim identifikimin e prioriteteve të qeverisë. Pra, duke identifikuar intervenimet e menduara që do të ndodhin, do të vlerësohet përbushja e politikave.

Sa i përket metodës, janë shfrytëzuar disa teknika. Më kryesore janë intervistat e bëra me zyrtarë dhe anëtarë të shoqërisë civile të përfshirë në proceset përkatëse, si në nivel qendror, poashtu edhe atë lokal. Debatet e organizuara në 5 qendra rajonale të Kosovës poashtu kanë shërbyer si indikator se sa janë zbatuar veprimet e caktuara të një politike. Pjesë e metodës ka qenë edhe monitorimi i veprimeve të institucioneve përmes medieve dhe raporteve të ndryshme. Indikator vlerësimi do të jenë përbushja e një veprimi të caktuar, si dhe koha e përbushjes..

¹ Drugs and Society, Glen H. Ranson. Page 39

² A. Bryman, Social Research Methods, Second Edition, Oxford University Press, Oxford 2005, page 40

Politikat e Kosovës në luftimin e drogave

Në procesin shtetndërtues, Kosova ka trashëguar politikat e UNMIK-ut në luftimin e drogave. Këto politika u përshtatën me rrëthanat e reja pas shpalljes së pavarësisë, duke autorizuar institucionet vendore që të hartojnë dhe zbatojnë politikat. E gjithë kjo ka vënë institucionet vendore para sprovave shtet-formuese.

Politikat kundër narkotikëve kanë qasje të integruar. Kjo nënkupton përfshirjen e fushave të ndryshme, siç janë ajo e sigurisë dhe shëndetësisë dhe shumë institucioneve në bëjen e politikave dhe zbatimin e tyre. Në këtë mënyrë, synohet të punohet në rrafshin parandalues, si dhe luftimin e rrjeteve kriminale, sikurse edhe rehabilitimin e viktimateve të varura nga përdorimi i narkotikëve. Obligimet e secilit institucion përcaktohen me Ligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë.³ Ky ligj rregullon mënyrën e përdorimit të drogave nga institucionet e licencuara, si dhe përcakton autoritetet mbikëqyrëse. Poashtu, përcakton edhe institucionet të cilat duhet të luftojnë keqpërdorimin e drogave.

Përveç ligjit, Kosova ka edhe Strategjinë Kombëtare kundër Narkotikëve 2009-2012. Kjo strategji është aprovuar në qershor të vitit 2009. Në bazë të strategjisë formësohen tri objektiva themeltare që janë:

- Reduktimi i kërkesës
- Reduktimi i ofertës dhe furnizimit, si dhe
- Bashkëpunimi ndërkombëtar

Reduktimi i kërkesës ka më shumë rol parandalues. Edukimi i të rinjve përmes programeve ka për qëllim të ulë numrin e përdoruesve potencial të drogës, dhe futja e kurikulumeve shtesë në shkolla (sidomos filllore), është një ndër mundësitë.⁴ Gjithashtu, rehabilitimi i viktimateve ka për qëllim që përdoruesit aktual të largohen nga varshmëria e krijuar. Reduktimi i kërkesës është shumë i rëndësishëm, sepse krijon më pak mundësi tregu për grupet kriminale. Në këtë mes, rol primar ka Ministria e Shëndetësisë.

Ndërsa, reduktimi i ofertës dhe furnizimit ka të bëjë me veprimtarinë e policisë në luftimin e grupeve kriminale që ofrojnë dhe furnizonë me drogë. Luftimi i këtyre grupeve nuk bëhet vetëm për drogën që ka destinacion Kosovën, por edhe vendet tjera e sidomos BE-në. Suksesi në këtë fushë ndikon në uljen e përdoruesve të drogës, shpërbërjen e grupeve kriminale, dhe tregon vendosmëri tek vendet tjera për një partner të besueshëm.

Pasi që kultivimi dhe destinimi i narkotikëve përfshinë shumë vende, poashtu struktura e grupeve kriminale është e shtrirë në shumë vende. Për këtë, bashkëpunimi ndërkombëtar kundër drogave është shumë i rëndësishëm. Deri më tanë ky bashkëpunim realizohet përmes UNMIK-ut dhe EULEX-it.⁵ Për arsyen politike, anëtarësimi i Kosovës në institucionet ndërkombëtare si Europol mbetet një sfidë.

³ Gazeta Zyrtare, Ligji për barnat narkotike, substancat psikotrope, dhe prekursorë, Ligji Nr. 02/L-128. 2008.

⁴ Intervistë me Faik Hotin, Drejtës për komunikim, MSH, 3 mars 2011

⁵ Intervistë me Bahri Shala, Ushtrees i Detyrës së Drejtorisë për Hetim të Narkotikëve, realizuar me 22 prill 2011.

Mekanizmat institucional dhe prioritetet në bazë të PVPE

Me lëvizjet në mënjanimin e kontrolleve kufitare, krijohet rreziku në qarkullim më të madh të lëndëve narkotike, sepse kufiri si vijë mbrojtëse nuk do të jetë. Ky fakt rritë nevojën për të forcuar institucionet vendore, si dhe rritjen e bashkëpunimit me vendet evropiane për luftimin e kontrabandimit të drogave. Kosova ende nuk ka kontroll të plotë të kufirit (shembull: me Serbinë), duke u mundësuar grupeve të ndryshme të vazhdojnë përdorimin e territorit kosovar për transportimin e lëndëve narkotike.⁶ Duke pasur parasysh gjendjen politike dhetë rendit në pjesën veriore të vendit, atëherë duket se do të shkoj kohë e gjatë kur institucionet e Kosovës do të kontrollojnë tërë vijën kufitare.⁷

Forcimi i institucioneve vendore në kornizat e një qasje të integruar nënkuption bashkërendim dhe bashkëpunit në mes të institucioneve. Për të realizuar këtë bashkëpunit, eshtë formuar Grupi Bashkërendues (GB). Politikat e Kosovës në luftimin e drogave kanë paraparë edhe themelimin e Grupit Bashkërendues, i cili do të duhej të bashkërendoj veprimet në luftimin e drogave. Strukturimi i grupit në bazë të praktikave ndërkombëtare (evropiane) duhet të jetë në tri nivele.

Niveli i parë në rang ministrash ose zëvendësministrash, të cilët takohen dy herë në vit dhe marrin vendime të rëndësishme në orientimin e politikave. Niveli i dytë eshtë ai i zyrtarëve të lartë. Detyra e këtij niveli eshtë të konkretizoj bashkërendimin duke mbikëqyrur punën e nivelit të tretë. Niveli i tretë eshtë një ndër nivelet më të rëndësishme, sepse hartimi i politikave dhe zbatimi i tyre lidhet me këtë strukturë. I përbërë nga ekspertë të politikave dhe zyrtarë të lartë për implementimin e tyre, ky grup paraqet bërthamën e Grupit Bashkë-rendues. Në Kosovë, ky grup eshtë jofunksional. Aq më tepër nuk eshtë i strukturuar në këtë

mënyrë ku përgjegjësitë dhe detyrat do të ndaheshin në mënyrë konkrete. Strategja për luftimin e drogave eshtë kryesish e orientuar në policinë e Kosovës dhe nuk eshtë gjithë-përfshirëse.

Gjithashtu strukturat që janë direkt të lidhura me luftimin e drogave nuk janë mirë të koordinuar.⁸ Për të eliminuar këto mangësi strategja duhet të hartohet nga Grupi Bashkërendues duke përfshirë komponentët e të gjithë akterëve tjerë relevantë, siç eshtë Ministria e Arsimit ose Doganat e Kosovës. Natyra e marrëdhënieve në grup duhet të jetë horizontale duke vënë të gjitha palët të barabarta në përcaktimin e përgjegjësive. Aktualisht, në rrafshin formal, MPB-ja ka primatin në GB, ndërsa praktikisht të gjitha ministritë janë të barabarta (shembull: ministri i MPB-së nuk mund të kërkoj përgjegjësi nga ministri i shëndetësisë, sepse janë të barabartë në rrafshin hierarkik).

Strategja Kombëtare për Luftimin e Narkotikëve përfshinë të gjitha institucionet relevante,⁹ pra promovon një qasje të integruar. Megjithatë, nga hulumtimi eshtë vërejtur se në praktikë Kosova nuk ka një qasje të integruar. Vetëm Policia e Kosovës eshtë aktive në hetimin e kësaj dukurie, përderisa institucionet tjera nuk janë angazhuar në përbushjen e detyrave të veta. Strategja kundër drogave nuk eshtë e balancuar në kuptimin e pjesëmarries dhe ndarjes së përgjegjësive në mes të institucioneve. Në këtë rrafsh, vërehet edhe mungesa e qendrave të specializuara dhe aktivitetave të shoqërisë civile, të cilat do të ndihmonin në hartim dhe zbatim të politikave kundër përdorimit të drogës.

Mangësi tjetër në zhvillimin e politikave të mira eshtë vërejtur edhe mungesa e një qendre të monitorimit, vlerësimit dhe integrimit të të dhënavë. Kjo qendër do të ndikonte në përcaktimin e problemit dhe se çfarë hapash duhet të ndërmerren. Rrjedhimisht, ende nuk dihet se sa përdorues të narkotikëve ka në vend.

⁶ Milan Sekuloski, The EU's changing role in Kosovo: what next?, European Security Review, Number 29, Issue June 2006 at http://www.isis-europe.org/pdf/esr_30.pdf

⁷ Forumi për Siguri, Menaxhimi i integruar i kufirit në Kosovë, dhjetor 2010

⁸ Seri e debateve organizuar nga FIQ dhe organizatat partnerë: "Zbatimi i politikave kundër narkotikëve ilegalë dhe roli i shoqërisë", shkurt – mars 2011

⁹ Intervistë me Valon Krasniqin, koordinator përfshirës i Strategjisë Nacionale nën përgjegjësinë e MPB-së, 22 prill 2011

PVPE

Plani i Veprimit për Partneritet Evropian përmban prioritetet e qeverisë në hartim dhe zbatim të politikave. Si dokument paraqet kriterin kohë, institucionet përgjegjëse si dhe ndarjen buxhetore. Prandaj, është plan i përshtatshëm në vlerësim të zbatimit të politikave.

PVPE ndahet në disa kategori siç janë: aspektet legjislative, kapacitetet institucionale, dhe aspektet teknike si furnizim me pajisje.¹⁰ Sa i përket drogave ky plan përfshinë shumë çështje që duhet përbushur. Pika themelare ka qenë zhvillimi i një strategjie për parandalimin e drogave dhe një plan përkates i veprimit për zbatimin e strategjisë.

PVPE në fushën e drogave identifikon këto veprime:

- Implementimi i projektit kapital (konfidencial) për përgjim ligjor- K4 - 2010 PK, MPB, Strategjia kundër Krimtit të Organizuar
- Sigurimi i pajisjeve dhe ofrimi i trajnimeve për personelin kompetent për luftimin e trafikimit të drogave- K4 – 2010, PK, MPB, Struktura e re Organizative e PK-së, Plani i Trajnimeve të PK-së për 2010
- Shtimi i numrit të personelit për 20 në Sektorin e PK-së për Hetimin e Narkotikëve- K4 – 2010, PK, MPB, Struktura e re Organizative e PK-së
- Caktimi i prokurorëve përgjegjës për çështjet e drogave- K3 – 2010, PSH, Strategjia kundër Drogave
- Të sigurohet trajnim i specializuar për prokurorët përgjegjës për çështjet e drogave- K4 – 2010, PSH, Strategjia kundër Drogave
- Aftësimi i personelit të PK-së, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe të Doganës së Kosovës, përmes trajnimeve të specializuara me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në luftimin e drogave - K4 – 2010, PK, Strategjia Kombëtare dhe PV kundër Drogave
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit në luftimin e drogave, duke filluar nga integrimi i qarkullimit të informatave- K2 – 2010, MPB, PK, Strategjia Kombëtare dhe PV kundër Drogave
- Rritja e numrit të qenve të trajnuar për zbulimin e drogave në kuadër të Njësisë së Qenve, PK- K3 - 2010 PK, MPB, Strategjia Kombëtare dhe PV kundër Drogave
- Sigurimi i objekteve adekuate (dhomave të dëshmive) për depozitimini e drogave të konfiskuara nga policia, si dhe i pajisjeve adekuate për ruajtjen e tyre në mbarë Kosovën- K4 – 2010, PK, MPB, Prioritetet Strategjike të Qeverisë për Integrin Evropian për vitin 2010
- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit përcjellës lidhur me zvoglimin e dëmeve shëndetësore dhe sociale që kanë të bëjnë me drogën- K4 – 2010, MSH, Strategjia kundër Drogave
- Themelimi dhe funksionalizimi i Qendrës për Rehabilitim Social- K4 – 2012, MPMS, Strategjia kundër Drogave
- Të sigurohet bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe në mes agjencive, për të përmirësuar rezultatet në luftën kundër trafikimit të drogave
- Mbajtja e trajnimeve të avancuara për 290 zyrtarë doganor në lëmin e hetimeve kriminale, teknikave dhe metodave të intervistimit; narkotikëve dhe inteligjencës kriminale- K4 - 2010 DK, Plani operacional i Drejtorisë se zbatimit të ligjit si dhe KPAT.

¹⁰ Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani i Veprimit 2010 për Implementimin e Partneritetit Evropian për Kosovën, Prishtinë, korrik 2010.

Rezultatet

Legjislacioni nuk shihet si problem në zbatimin e politikave kundër narkotikëve.¹¹ Kodi i Përkoħshem Penal i Kosovës dhe Ligji pér Substanca Narkotike dhe Psikotropike shihen si të mjaftueshém. Megjithëse dhënia e terapisë me metadon pér pacientët narkomanë ende nuk është rregulluar me ligj të veçantë.¹² Por, sfidë e vërtetë mbetet zbatimi i legjislacionit ekzistues si rrjedhojë e mekanizmave institucional.

Veprimi i PK-së kundër drogave është: zbulimi i kryerësve të veprave, konfiskimi i substancave dhe sjellja e të dyshuarve para drejtësisë, si dhe vetëdijësimi pér këtë dukuri përmes ligjératave nëpër shkolla. Brenda vitit, policia realizon afér 150 operacione me qëllim gjetjen, konfiskimin e narkotikëve dhe arrestimin e personave të dyshuar (shih tabelën nr. 1).¹³ Për të përmbushur këtë mision duhet bërë forcimi i kapaciteteve lokale. Njësitet regionale kanë të angazhuar nga tre punonjës dhe nga formimi i tyre nuk është rritur numri. Në bazë të PVPE, nga 44 punonjës pér tërë njësinë numri është dashur të rritet pér 20 persona, por kjo nuk është bërë. Në bazë të parashikimeve të PK-së gjithsej duhen 86 punonjës me qëllim që tërë njësia të bëhet efikase.¹⁴

Një nga kriteret e PVPE janë edhe trajnimet me qëllim të rritjes së efikasitetit të stafit aktual. Në këtë pikë, PK ka përmbushur këtë aktivitet duke mbajtur trajnime rregullisht. Trajnimet janë fokusuar në droga, aspektet ligjore, dhe shkëmbim i përvojave me vendet perëndimore. Nevojë më të madhe ka pér trajnime se çfarë qasje duhet të kenë ndaj personave që janë konsumues të narkotikëve. Sfidë në aspektin afatgjatë dhe të qëndrueshmërisë është zhvillimi i programit kombëtar të trajnimeve, të cilat nuk do të vareshin nga donacionet e

jashtme dhe stafi profesional i vendeve tjera.

Sa i përket qenve të trajnuar në anti-narkotikë, njësitet regionale nuk kanë në shfrytëzim. Këta qenë janë të njësisë së qenve në kuadër të PK-së. Njësitet regionale në bazë të nevojave mund të bëjnë kërkesë pér ndihmë nga kjo njësi. Dhe, nga intervistimet e bëra, numri i qenve pér nuhatje të substancave narkotike është rritur duke mbuluar nevojat e DHN (Drejtoria pér Hetim të Narkotikëve).¹⁵

Blerja e pajisjeve të ndryshme ka pér qëllim rritjen e kapaciteteve të PK-së. Në këtë fushë, PK ka mungesë të mjeteve. Pothuajse të gjitha njësitet regionale kanë mungesë të veturave ose në shfrytëzim me njësitet tjera. Po ashtu, mjetet pér teste fushore mungojnë (duhen pér verifikim të llojit të narkotikëve). Në njësitet regionale mungojnë laboratorët, andaj shfrytëzohet laboratori i qendrës, duke ndikuar në vonesë të rezultateve në terren. Gjithashtu, pajisjet tjera teknologjike të avancuara mungojnë. Në aspektin afatgjatë (si në rastin e Shqipërisë) pajisja me helikopter pér detektim të kultivimit të narkotikëve është me rëndësi të madhe.

Edhe hapësira pér punë është shqetësuese. Ndonëse është paraparë rritja e hapësirës pér këto njësi, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Përveç zyreve të vogla, mangësia është edhe tek mungesa e dhomave të veçanta pér intervistim të personave. Asnjëra nga njësitet regionale nuk ka hapësirë të mjaftueshme. Rritja e personelit pér këto njësi e bën edhe më të vështirë punën efikase. Sa i përket dhomës së ruajtjes së dëshmive nuk ka dhoma të veçanta, por shfrytëzohen ato të stacioneve regionale.

¹¹ Intervistë me Njësitet Regionale kundër Narkotikëve, në Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Gjilan dhe Prizren, shkurt – mars 2011.

¹² Intervistë me Dr. Ilir Begolli, Drejtor I Mjekësisë sociale-IKSHP, 02 Mars 2011

¹³ Brahim Sadriu Zédhënës i Policisë së Kosovës, korrespondencë permes postës elektronike, 27 Prill 2011

¹⁴ Intervistë me Bahri Shala, U.d i Drejtorisë pér Hetim të Narkotikëve, realizuar me 22 prill 2011.

¹⁵ Njësia e qenëve në PK momentalishtë ka në dispozicion vetëm tetë (8) qen.

Sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional, PK ka bashkëpunim të mirë me prokurorinë, por ende nuk janë caktuar prokurorë të veçantë për drogat. Kjo ndikon në efikasitet, sepse sikur të ketë prokurorë të caktuar për drogat, bashkëpunimi dhe bashkërendimi do të ishin në nivel më të mirë. Bashkëpunimi i policisë me institucionë tjera si Doganat e Kosovës, Gjykata, Qendra Korrektuese, dhe shkollat është i mirë. Megjithatë, pengesë është mosidentifikimi i një objektive të qartë dhe të përbashkët, përkatësisht përkushtimi për një objektiv. Bashkëpunimi cenohet edhe nga mungesa e kapaciteteve të institucioneve tjera. Shembull, Ministria e Shëndetësisë nuk ka themeluar ndonjë qendër rehabilituese dhe mungesa e infrastrukturës dhe institucioneve tjera ndihmëse ndikon në bashkëpunim jopërmnjësor.

Siq u tha më lartë, bashkëpunimi ndërkombëtar është i rëndësishëm për detektimin dhe eliminimin e grupeve kriminale që merren me kultivimin dhe shitjen e drogave. Bashkëpunimi ndërkombëtar ka dy dimensione. Dimensioni i parë është anëtarësimi në institucionë ndërshtetërore me qëllim të luftimit të grupeve ndërkombëtare duke shkëmbuar informacione dhe marrjen e veprimeve të përbashkëta. Duke mos qenë e njohur nga disa vende evropiane dhe më gjërë, Kosova nuk ka mundur të anëtarësohet në mekanizma ndërkombëtar si Interpol, Europol, dhe SECI¹⁶(Nisma e Evropës Jug-lindore për Bashkëpunim). Në këtë gjendje, PK zhvillon bashkëpunimin me këta mekanizma përmes UNMIK-ut dhe EULEX-it. Dimensioni i dytë është me vendet fqinje dhe shtetet që kanë njohur Kosovën. Autoritetet vendase deri më tani kanë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi në luftimin e krimit të organizuar.¹⁷

PËRDORUES TË DYSUAR Vitet: 2001 - 2009	TË DHËNAT
Numri i përdoruesve:	4.000 deri në 6.000 përdorues të drogës (shifër e pakonfirmuar)
Mosha:	15-35 vjeç
Gjinia:	Meshkuj: 96 % Femra: 4 %
Përkatësia etnike:	Shqiptarë: 92 % Të tjerë: 8 %
Vendet e përdorimit:	Mjedise shtëpiake, bare, dyqane, klube, në rrugë apo vende të izoluara, në parqe dhe banjo publike dhe në shkolla.
Faktorët që ndikojnë në përdorimin e drogës:	Kurrestja rinore; Presioni i grupit apo presioni i jashtëm shoqëror; Problemet ekonomike; Dobësi të karakterit; Problemet familjare; Rrugëdalje nga monotonia, etj.
Institucionet parandaluese:	Familja; Institucionet edukative; Mediet; Qeveria; Komuniteti; Policia, etj

Tabela nr.1. Të dhëna nga Policia e Kosovës sa i përket situatës së përdorimit të drogës në Kosovë nga viti 2001- 2009

¹⁶ SECI është organizatë regionale operacionale që ofron policië dhe doganat e 13 shteteve nga Evropa Jug-lindore. Për më shumë shiko <http://www.seicenter.org/>

¹⁷ Për shtjellim më të gjërë të kësaj çështje shiko: Forumi për Iniciativa Qytetare 'Sundimi i Ligjit: kapacitetet dhe funksionimi i institucioneve', nëntor 2010, tek: <http://fci-fci.org/repository/docs/Sundimi%20i%20ligjit%20kapacitetet%20dhe%20funksionalizimi%20i%20institucioneve.pdf>

Analizë

Strategjia Kombëtare për luftimin e narkotikëve përfshinë të gjitha institucionet relevante, pra promovon një qasje të integruar. Megjithatë, nga hulumtimi është vërejtur se në praktikë Kosova nuk ka një qasje të integruar. Vetëm Policia e Kosovës është aktive në hetimin e kësaj dukurie përderisa institucionet tjera nuk janë angazhuar në përbushjen e detyrave të veta. Shembull, edukimi i të rinjve për rrezikun dhe pasojat nga drogat duhet të bëhet nga MASHT dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë. Megjithatë, ky vetëdijësim bëhet nga PK. Strategjia kundër drogave nuk është e balancuar në kuptimin e pjesëmarrjes dhe ndarjes së përgjegjësive në mes të institucioneve. Në këtë rrafsh vërehet edhe mungesa e qendrave të specializuara rehabilituese në të cilat do të bëhej edhe dhënia e terapisë me metadon.¹⁸ Gjithashtu vërehet mungesa e angazhimit të shoqërisë civile, e cila do të ndihmonte në hartim dhe zbatim të politikave kundër përdorimit të drogës.

Mangësi tjetër në zhvillimin e politikave të mira është vërejtur edhe mungesa e një qendre të monitorimit, vlerësimit dhe integrimit të të dhënave. Kjo qendër do të ndikonte në përcaktimin e problemit dhe se çfarë hapash duhet të ndërmerr. Rrjedhimisht, ende nuk dihet se sa përdorues të narkotikëve janë. Në nivel lokal kundër drogave nuk bëhet shumë. Njëjtë është edhe në nivel kombëtar, ndërsa veprimi është edhe më i vogël në nivel transnacional.

Krahasimi i aktiviteteve të parapara në PVPE dhe rezultatet nga terreni tregojnë për mospërbushje të objektivave. Përveç rritjes së numrit të qenve, pikat tjera çalojnë dhe nuk janë përbushur. Kjo ndikon në mungesë të rezultateve konkrete duke lënë hapësirë për akuzim nga vendet tjera në drejtim të Kosovës. Gjithashtu, nga debatet e realizuara dhe raportet tjera, numri i përdoruesve të drogave është në rritje duke bërë Kosovën vend jo vetëm vend transit, por edhe vend destinimi të drogave. Mungesa e veprimeve në reduktimin e kërkesës përkatësisht kufizimi vetëm në vetëdijësim të nxënësve, pa pasur qendër për rehabilitimin e personave që janë të varur nga narkotikët, ndikon në rritjen dhe shterrjen e kapaciteteve të policisë. Rehabilitimi bëhet vetëm për rastet ekstreme në Klinikën Neuropsikiatrike të QKUK-së, por rastet tjera nuk kanë trajtim në Kosovë. Prandaj, Qendra për dhënien e metadonit është më se e nevojshme.

¹⁸ Metadoni është një preparat i cili ka edhe efektet e drogës, por jo ato efekte negative që japid drogat e tjera dhe sidomos heroina. Ky ilaç është shpikur për të zëvendësuar heroinën, sidomos për ata persona që e përdorin heroinën me injektim.

Rekomandime

1. Institucionet e Kosovës duhet të `intensifikojnë bashkëpunimin ndërkontrollor përmes pasur produktivitet në luftimin e narkotik-ëve ilegal;
2. Institucionet e Kosovës duhet të rrisin kontrollin kufitar (sidomos në veri të vendit), përmes parandaluar hyrjen e substancave narkotike ilegale;
3. Rekomandohet që urgjentisht të funksionalizohet Grupi Bashkërendues, që të arrihet forcimi i institucioneve vendore me një qasje të integruar në luftimin e narkotik-ëve ilegal;
4. Strategjia Kombëtare kundër Narkotikëve duhet të hartohet nga Grupi Bashkërendues, duke përfshirë komponentet e të gjithë akterëve tjerë relevantë, siç është Ministria e Arsimit ose Daganat e Kosovës.
5. Strategjia duhet të paraqesë qartë koordinimin në mes të gjitha strukturave apo institucioneve përmes luftimit të narkotik-ëve.
6. Është nevojë emergjente krijimi i qendrave të specializuara të ekspertëve dhe shoqërisë civile, të cilat do të ndihmonin në hartimin dhe zbatimin e politikave kundër përdorimit të narkotik-ëve.
7. Rekomandohet krijimi i një qendre të monitorimit, vlerësimit dhe integrimit të të dhënave, ku në këtë mënyrë do të dihej numri i saktë i konsumuesve dhe abuzuesve të narkotik-ëve.
8. Është shumë i nevojshëm miratimi i ligjit përmes dhënie të metadonit, i cili do të rregullonte kushtet përmes dhënie të terapisë.
9. Njësitë regionale të Policisë së Kosovës kanë nevojë të madhe përmes rritje të personelit, sepse numri i tanishëm është mësues i pamjaftueshëm.
10. Duhet të rritet numri i qenve në Njësinë e Qenve dhe gjithashtu Njësitë regionale duhet të kenë në shfrytëzim qantë.
11. Rekomandohet pajisja me mjetet e nevojshme në njësitë regionale si: rritja e numrit të veturave dhe mjetet përmes teste fushore që verifikojnë llojin e narkotikut.
12. Njësitë regionale do të duhej të kishin laboratorë, sepse shfrytëzimi i laboratorit të qendrës ndikon shumë në vonesë të rezultateve në terren.
13. Rekomandohet të ketë dhomë të veçantë përmes intervistikës së abuzuesve të drogave dhe gjithashtu të ketë dhomë të veçantë të ruajtjes së dëshmive.
14. Sa më shpejtë që është e mundur duhet të caktohen prokurorë të veçantë që merren vetëm me çështje të narkotik-ëve.
15. Ministria e Shëndetësisë rekomandohet të themelojë qendër rehabilituese dhe infrastrukturë të nevojshme ndihmëse përmes trajtimit të narkomanëve.
16. Edukimi i të rinjve sa i përket dëmeve që shkakton përdorimi i drogës është mësues i nevojshëm dhe futja e kurrikulumeve të tillë në institucionet edukative është mësues i nevojshme.

Bibliografia:

1. G. R. Hanson, P. J. Venturelli, and A. E. Fleckenstein, Drugs and society, 10th ed, Jones and Bartlett Pub, 2009
2. A. Bryman, Social Research Methods, Second Edition, Oxford University Press, Oxford 2005

Dokumente online:

1. Milan Sekuloski, The EU's changing role in Kosovo: what next?, European Security Review, Number 29, Issue June 2006 at http://www.isis-europe.org/pdf/esr_30.pdf.
2. Forumi për Iniciativa Qytetare, 'Sundimi i Ligjit: kapacitetet dhe funksionimi i institucioneve', nëntor 2010, tek: [http://fiq-fci.org/repository/docs/Sundimi_i_Ligjt%20kapacitetet%20dhe%20funksionalizimi%20i%20institucioneve.pdf](http://fiq-fci.org/repository/docs/Sundimi_i_Ligjit%20kapacitetet%20dhe%20funksionalizimi%20i%20institucioneve.pdf)
3. Gazeta Zyrtare, Ligji për barnat narkotike, substancat psikotrope, dhe prekursorë, Ligji Nr. 02/L-128. 2008, tek: <http://www.gazetazyrtare.com/>
4. Forumi per Siguri, Menaxhimi i integruar i kufirit në Kosovë, dhjetor 2010, tek: http://www.fiq-fci.org/repository/docs/Menaxhimi_i_integruar_i_kufirit.pdf
5. Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani i Veprimit 2010 për Implementimin e Partneritetit Evropian për Kosovën, Prishtinë, korrik 2010, http://www.meks.net/repository/docs/PVPE_2010_Final_-_SQ.pdf

Intervista dhe debate:

6. Intervistë me Njësitet Regionale kundër Narkotikëve, në Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Gjilan dhe Prizren, shkurt – mars 2011.
 7. Intervistë me Dr. Ilir Begolli, Drejtor I Mjekësisë sociale-Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike, 02 Mars 2011
 8. Intervistë me Faik Hotin, Drejtor për komunikim, Ministria e SHëndetësisë, 3 mars 2011
 9. Intervistë me Valon Krasniqin, koordinator për evaluim, raportim dhe implementim të Strategjive Nacionale nën përgjegjësinë e MPB-së, 22 prill 2011
 10. Intervistë me Bahri Shala, Ushtrues i Detyrës së Drejtorisë për Hetim të Narkotikëve, Policia e Kosovës, 22 prill 2011
 11. Brahim Sadriu, zëdhënës i Policisë së Kosovës, korrospodencë permes postës elektronike, 27 Prill 2011
 12. Seri e debateve organizuar nga FIQ dhe organizatat partnerë: "Zbatimi i politikave kundër narkotikëve ilegalë dhe roli i shoqërisë", shkurt – mars 2011
- .

Ky raport është pjesë e projektit "Rritja e mbikëqyrjes publike në sundimin e ligjit në Kosovë", dhe ka për synim rritjen e përfshirjes së qytetarëve në mbikëqyrjen e institucioneve të ligjit. Në nivelin qendror, FIQ në partneritet me KLI analizon politikat e qeverisë në fushën e sundimit të ligjit përkatësisht: trafikim të qenieve njerëzore, krimë ekonomike dhe financiare, qasjen e barabartë në drejtësi, dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në drejtësi. Ndërsa, pesë organizata partnerë merren me vlerësimin e zbatimit të këtyre politikave në nivelin lokal.

Me këtë vlerësohet përmbushja e aktiviteteve të PVPE-së në sundim të ligjit në nivel lokal. Të gjeturat e këtij projekti i shpërndahen institucioneve politikëbërëse dhe medieve. Kështu, synohet të rritet mbikëqyrja e parlamentit ndaj qeverisë dhe përfshirja më e madhe e shoqërisë civile në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave.

Ky projekt mbështetet nga: National Endowment for Democracy (NED)



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world



Forumi për Iniciativa Qytetare

tel.+381(0)38 248 677
Rr. Rexhep Mala 5/A
10 000 Prishtinë, Kosovë
www.fiq-fci.org
www.safeplaceproject.org